


Home / Aktualitet / DOSSIER/ Kur ishim “Kuaj” të një regjimi të egër dhe 30- vjetori i një poezie që krisi muret e diktaturës

# DOSSIER/ Kur ishim “Kuaj” të një regjimi të egër dhe 30- vjetori i një poezie që krisi muret e diktaturës

Posted on 19 Gusht, 2020 12:22 by A in Aktualitet, AKTUALITET BLOKU HOMEPAGE, Dossier with 12 Comments



*-Poezia “Kuajt” e Gjekë Marinaj, e shkruar në vitin 1990 është një poezi simbolike që lidhet me historinë e arratisjes së një poeti në fundin e diktaturës. Ajo shënoi hapin e parë të lirisë së shqiptarëve për të shkruar drejt Amerikës, duke kapërcyer çdo procedurë zyrtare dhe diplomatike*

## Nga Dhurata Hamzai

Ishte vetëm një poezi ajo që bindi Ambasadën Amerikane në Beograd, që ta lejonte një 22-vjeçar të arratisur nga Shqipëria në vitin 1990, të jetonte i lirë në Amerikë. Vetëm një vit para rënies së diktaturës, për shkak të një poezie, që u përhap ilegalisht tek njerëzit dhe prekte thelbin e shtypjes diktatoriale në Shqipëri, jeta e të riut Gjekë Marinaj ishte në rrezik. I ndjekur nga Sigurimi i Shtetit, djaloshi nga Bajza e Shkodrës mund të burgosej ose të ndëshkohej me qindra mënyra, duke përfshirë edhe familjen e tij. Ankthi sa vinte e shtoej

dhe që ndoshta ajo britma e brendshme e poezisë së tij, që e shtyu të merrte malet duke u arratisur nga atdheu i vet me një çantë me libra në shpinë. Po largohej duke rrezikuar edhe jetën, që të mos mbetej kurrë më një nga kuajt para njeriut.

Ka shumë arsye për t’u festuar 30-vjetori i kësaj poezie, që ende ka jehonën e një balade të sprasme të historisë së diktaturës.

Ja poezia:

“Kluajt”, Gjekë Marinaj

...  
Tërë jetën duke vrapuar rrimë  
Shohim veç përpara  
Ç’bëhet prapa s’duam t’ia dimë.  
Ne nuk kemi emër  
Të gjithëve kuaj na thonë.  
Nuk qajmë,  
Nuk qeshim;  
Heshtim,  
Dëgjojmë;  
Hamë atë ç’na japin,  
Ecim nga na thonë,  
Asnjë nga ne s’është mendje hollë.



Dhurata Hamzai

Kush që kalë mbreti,  
Posti që i lartë  
Kush që kalë princeshe  
I bënë shalë të artë  
Kush që kalë fshatari  
Pat samarë me kashtë  
Kush që kalë i egër  
Tërë jetën fjeti jashtë.  
Po qemë dhe mbetem kuaj, para njeriut.

Është pikërisht 30-vjetori i një poezie që mbart në shpinë historinë tonë të rënies së komunizmit dhe ditëve të para të lirisë; një poezi që vinte nga një poet i ri, ende anonim. Në fakt në vitin 1990, kur u shkrua kjo poezi, diktatura komuniste ishte ende në pushtet. Autori i saj Gjekë Marinaj ishte atëherë një student 22-vjeçar, që e ndjente shtypjen e saj kudo, ishte vetëm një i rebeluar shpirtërisht kundër shtypjes së saj. Poeti sapo kishte rënë në sy në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe poezia e botuar në gazetën “Drita” më pas mori të drejtën të interpretohej në qindra mënyra, përtej asaj shtypjes së qartë që ndihet në tekstin dhe kontekstin poetik.

Arratia e Gjekë Marinaj drejt Amerikës më 12 shtator të vitit 1990 kaloi çdo parashikim që kishte bërë auri për jetën dhe karrierën e tij. Por sot nuk është rasti që të flasim për arritjet e Marinajit, se tashmë ai është një emër i njohur edhe në letërsinë botërore.

Në një intervistë të shumë viteve më parë, dhënë për gazetën “TemA”, ku punoja atëherë, Gjekë Marinaj rrëfen pikën kulmore, kur mori kthesën e gjithë jeta e tij, ndërkohë që kthesa e madhe po shënohej edhe brenda vendit, por jo pa heronj dhe sakrifica.

Gjekë Marinaj, gjatë intervistës ka rrëfyer bisedën me Ambasadorin Amerikan në Beograd, kur i thotë se “Unë kam një poezi. Qe ajo poezi shkak që më solli deri këtu.

– “Këtu në Beograd e ke?,- tha ambasadori.

“- Po, tha Gjeka”.

“- Me vete?”

“- Jo, – tha Gjeka, – e kam në Hotel”.

“- Atëhere në rregull, – më tha, sille nesër”... rrëfen poeti.

Dhe ditën tjetër ai merr bekimin prej kësaj poezie. Ambasadori i pati thënë : “Paç fat në Amerikë, bir!”.

Në kujtim të kësaj poezie, e cila edhe për autorin ka më shumë vlerë simbolike sesa artistike, le të risjellim një pjesë të intervistës sime me Gjekë Marinaj, ku as më shumë, as më pak lihet të kuptohet se kjo poezi hyn legjitimisht në historinë e rënies së mureve të dikaturës. Ajo shënoi hapin e parë të lirisë së shqiptarëve për të shkruar drejt Amerikës, duke kapërcyer çdo procedurë zyrtare dhe dipolomatike.

Pjesë nga intervista:

### Sigurisht që historia e arratisjes suaj të bën shumë kurioz. A mund të na tregoni diçka rreth asaj ngjarjeje, e cila ishte e ndëshkueshme në sistemin totalitar?

– Po, poezia “Kuajt” u bë shkak. Unë mora lajmin se do të shkoja dhe do të takohesha në Degë të Brendshme, të nesërmen në orën 8.00 të datës 12 shtator, dhe të them të drejtën u zura ngushtë, sepse e dija se çfarë kanë bërë me poetët e tjerë. Dijsa për ata që e kishin kundërshtuar regjimin dhe pa u matur shumë mora një çantë me libra dhe më shkoi mendja për të kaluar klonin dhe kalova në Jugosllavi. Ishte diçka që nuk kam shumë qejf ta sjellë ndërmend, se nuk e di... Ishte diçka më e thellë se loti, e unë nuk qaja dot... – Ishtit vetëm kur ikët? – Isha me një shokun tim. Vëllai i tij kishte ikur para dy-tre javësh dhe ai i dinte rrugët me diçka më mirë se unë. Por, për mua ishte diçka shumë e vështirë. Si do që të jetë puna, të ikësh nga atdheu është diçka e vështirë. Unë nuk mund ta riprodhoj dot në mendjen time atë ndjenjë që kam pasur kur po ngjitesha malit natën. Kështu që i hutuar, i trembur i zhgënjyer, i lodhur, plot dhimbje, unë nuk e dija se ç’po merrja me vete dhe se ç’po lija pas.

### Dhe qëndruat....?

– Qëndruam në Jugosllavi përreth nja dy javë. Në Jugosllavi na futën në një lloj burgu, por ishte diçka ndryshe nga burgu i vërtetë, sepse aty po na mbanin ne që kishim kaluar kufirin dhe po na investigonin; nga kishim ardhur, pse kishim ardhur dhe kush jemi. Për pak kohë, pasi na liruan, unë ndejta në Beograd në disa hotele, pastaj në kamp përqendrimi, për pak kohë, dhe kur erdhi koha që unë të ikja në Amerikë shkova tek Ambasadori Amerikan për intervistën dhe ai më tha “Ju paskeni punuar në Shqipëri tek disa gazeta dhe keni botuar poezi tek gazetata më me famë në Shqipëri, si tek “Drita”, etj. Unë nuk dija se çfarë ju ka bërë komunizmi. Si doni të ikni prej komunizmit? Ç’prova keni se e urreni komunizmin? Unë nuk e dija se ç’ti thosha për prova, sepse unë s’e dija se ç’donte të thoshte prova, por megjithatë unë i thashë se unë nuk dua të jem deklarativ, por unë kam një poezi që më solli deri këtu. “Këtu në Beograd e ke, më tha”. “- Po”. “Me vete?” “-Jo. i thashë, e kam në hotel”. “- Atëhere në rregull, më tha, sille nesër”. Për mua ishte shumë e vështirë të rrija dhe një ditë tjetër vetëm që të çoja atë poezi. Shkova ditën tjetër, ia lexoi përkthyesit dhe ai më tha “Paç fat në Amerikë, bir!”. Kjo ishte fjala që shoqëroi udhëtimin tim drejt Amerikës.

### ...Gjekë Marinaj në Amerikë...?

– Oh, në Amerikë e nisa me vështirësi si të gjithë të tjerët. Kur shkova gjuhën e flisja. Unë vija nga fshatrat e Shqipërisë me një kulturë minimale, pavarësisht se dëshirat e mia për njohuritë jashtëshkollore ishin të mëdha. Fillova të punoj si një punëtor i thjeshtë në një hotel, dhe më duhej që të rregulloj krevetat e të pastroj gjithë shkallën e hotelit. Mirëpo më duhej që të rregulloj 17 dhoma në ditë. Unë nuk kisha aftësi të vendosja aq rregull dhe nganjëherë më duhej të vija dorën në mes të krevetit dhe të kërcëja në anën tjetër në vend, që të mos harxhoja kohë duke u sjellë rrotull. Po ata e panë se unë s’e bëja dot këtë punë dhe për dy javë më dhanë një detyrë tjetër që ishte pak më e lehtë. Duhej të çoja jastëk, ose sende të tjera klientëve kur ata thirrnin dhe kështu punova për pak kohë. Pastaj unë e ndjeva se nuk doja të jetoja gjithmonë ashtu. Shkova dhe u regjistrova në shkollë. Vazhdova një institut mjekësor që në fakt e mbarova për tre vjet dhe fillova të punoj në spital si specialist i enëve të gjakut dhe që andej shkova në një kolegji dhe mbarova shkencat e përgjithshme. Sapo mbarova shkencat e përgjithshme, shkova në universitet, në Richland College, në Dallas të Teksasit (aty ku jap mësim). Është një katërveçjare për arte dhe letërsinë botërore dhe jam akoma në vazhdimësi për dy doktoraturat. Kam pesë vjet që punoj si pedagog i Letërsisë Botërore dhe i Komunikimit në anglisht...”...

Jeta dhe karriera e Gjekë Marinaj vazhdoi me shkëlqimin e saj në Amerikë dhe në rang botëror, por në këtë tridhjetëvjetor poezia e tij “Kuajt” ngre një pyetje pezull. “A jemi ende kuaj që:

“Nuk qajmë,  
Nuk qeshim;  
Heshtim,  
Dëgjojmë;  
Hamë atë ç’na japin,  
Ecim nga na thonë”. ....

Apo ende: “Asnjë nga ne s’është mendje hollë.”(TemA)


bluehost Get Started Today for \$2.75  
Everything you need to build the perfect website.



otpbank NORMË INTERESI 1.4% Kredi për Shtëpi Bëhu me shtëpi! Lëri të tjerët të merren me thashetheme!

NJË DITË MË E MIRË PO VJEN,

PA RADHË, PA KOSTO!  
Shkarko tani aplikacionin!



fga Bli më shumë, përfito më shumë -30% ULJE

hp NEPTUN PRINTONI FOTOT E PREFERUARA ME KOSTO MINIMALE 22.990

